

3.5.1 Skajoret (marrin mbaresa)

Më poshtë jepen disa aspekte kryesore të foljeve.

Veta

Sipas vetave, foljet e gjuhës shqipe ndahen në tri farë,

1. *Trivetore* – folje që kanë të gjitha (tree) vetat
2. *Njëvetore* – folje që kanë vetëm vetën e III^{të}
3. *Pavetore* – folje që nuk kanë vetë

Foljet e gjuhës shqipe kanë tri veta për njëjës dhe tri për shumës. Dy vetat e para nuk përdorin përemëna të ndryshëm për gjini të ndryshme. Vetat e treta kanë përemëna të ndryshëm, por trajtat foljore dalin të njëjta.

Veta	Njëjës	Shembuj	Shumës	Shembuj
I ^{re}	Un	shkruaj	Ne/Na	shkruajm(ë)
II ^{të}	Ti	shkruan	Ju	shkruani
III ^{të}	Ai/Ajo	shkruan	Ata/Ato	shkruajn(ë)

Numri

Foljet kanë dy numra, *njëjës dhe shumës*.

Secili numër ka tri veta: *vetat I, II, III njëjës dhe vetat I, II, III shumës*.

Numri dhe veta e foljes nuk e ndryshojnë kuptimin e fjalës. Folja ndryshon vetë e numër vetëm me iu përshtat kryefjalës. Mbarësa –oj në trajtën ‘punoj’ të foljes ‘punua’ tregon se personi që punon është në numrin njëjës dhe në vetën e parë. Mbarsa –ojm(ë) në trajtën ‘punojm(ë)’ të foljes ‘punua’ tregon se personat që punojnë janë në numrin shumës dhe në vetën e parë.

Gjinia

Në gjuhën shqipe, folja nuk ndryshon me tregua gjininë. Përemënat vetorë të vetave I dhe II, janë uniseks ose asnjëanës; nuk ndërron me tregua gjininë e vepruesit. Kurse, përemënat vetorë të vetës së tretë ndryshojnë me tregua gjininë e vepruesit.

Veta	Trajta Zgjedhimore	Gjinia
I	Un punoj Ne/Na punojmë	nuk shenjohej gjinia e vepruesit
II	Ti punon Ju punoni	
III	Ajo punon Ato punojnë	femnore
	Ai punon Ata punojnë	mashkullore

Kjo strukturë qendron pavarësisht prej zgjedhimit, mënyrës, kohës, a aspektit.

Diateza / Zani

Vetëm foljet kanë zë, ose diatezë. Këto ndërtime dobisohen me tregua marrdhanien në mes të kryefjalës (*bāsit*) dhe kundrinës (*marrësit të bāmës*).

Gjuha Shqipe ka pes diateza. Ato mund të ndahen në *diategjë veprorë ose pësorë*, ose në *zë aktiv dhe zë pasiv*. Zani pasiv ka ngjeshë psikologjike sepse ai e ven marrësin e veprimit në rend më të ulët se bāsin e veprimit. Gramatikisht, me zā kuptohet nēse kryefjala āsht aktive a pasive, “*viktimizues*” ose “*i viktimizuum*”. Nē qender tē dy zaneve qendrojnē foljet, tē cilat dalin nē dy trajta, **aktive**, p.sh. **shty-j**, dhe **pasive**, p.sh. **shty-hem**. Forma gramatikore ‘pasive’ e shqipes pērfshin edhe froma qē gramatikisht dalin pasive, por nē realitet pērshkruajn nē veprim aktiv, p.sh., *I ngjitem malit*. Pērveç pasives, forma joveprorë pērfshin edhe foljet, *mesorē, vetvetorē*, dhe *reciprokē*.

Koha

Nē gramatikē, koha shenjon se kur āsht kryem nē veprim ose kur ka egzistuum nē gjendje. Kohēt vērehen nē lidhje 1) me herjen (Pano) e ligjimin, ose 2) me nē herje nē tē kaluomen; prandaj, ato pērkojnē plotsisht me konceptin e kronologjisē (kohēs lineare).

Fjalja ‘*Filja ka bāmē detyrat*’ tregon se veprimi āsht kryem para ligjratēs.

Fjalja ‘*Martini kishte bāmē detyrat para orēs tetē*’ tregon se veprimi i Martinit u pat kryem para kēsaj ore.

Megjithē kēto ndryshime me kronologjinē, gramatika vērehet sipas kohēs lineare. Ajo shihet prej veprimtarisē sē nē agjenti, si nē, *Ajo shtyni derēn*. *Dielli nxenē tokēn*. Kēsi tē kuptuomit pērkon me shkencēn e shkakut dhe pasojēs, si nē *Dera u shty prej Files*, dhe me logjikēn propozicionale ku folja ‘qenē’ lidhē kryefjalēn me kallzuesin, si nē, *Sokrati āsht qenje racionale*.

Koha nē tē *tashmēn* dhe nē tē *pakryemēn* mund tē vērehet si rrethorē a pērsēritēsē sepse fjalitē *Aleksi noton*, ose *Shtojza vallzon*, tregojnē nē veprim tē pērsēritēshēm; por qē nuk po ndodhē tashpērtash. Sikur ky veprim tē ishte duke ndodhē, atbotē do tē duhej me pērdorē aspektin e vazhdimsisē: *Aleksi po noton*; *Shtojza po vallzon*.

5. Kohēt e gramatikēs dhe kumti mund tē mos pērshtaten. Pēr shembull, nē fjalinë, *Erdha, mos shko kund*, trajta ‘erdha’, megjithēsē del nē tē kaluomen, kumton nē çast nē tē ardhēmēn. Sikur folēsī tē donte me çansua veprimin e tij pērpiktazi, ai do tē thonte, *Jam duke ardhē*.

Nē fjalinë, *Dera hapet nē ora tetē*, folēsī pērdorē tē tashmēn (ajo hapet), por, nēnkupton tē ardhēmēn. Megjithatē, mund tē argumentohet se kjo fjalī āsht gramatikisht errtare. Por, fakti āsht se kēshtu pērdoret gjuha. Prandaj, shprehja qē mund tē duket gramatikisht e gabuome sot, mund tē bāhet norma e sē ardhēmēs, p.sh., e kryemja e kohēs sē Buzukut *me shkuom*, sot mund tē dali *me shkua*, *me shkue*, *me shku*.

Lula thotē Luka ka me u kthye vonē. Kētu trajta ‘thotē’ āsht nē tē tashmēn, por ajo nēnkupton nē veprim qē ka me ndodhē nē tē ardhēmēn.

6. Koha shenjohe duke eptua trajtēn bazē tē foljeve.

PpP	E kaluomja	E tashmja	E ardhēmja
lá	lá-va	lá-j	[do tē] lá-j kam me lá

Renditēsī i masipērm tregon se gjuha shqipe nuk ka mbaresa tē veçanta pēr tē ardhēmēn; dmth, ajo nuk ka kohē tē ardhēme autentike. Kēshtu, me iu referua tē ardhēmēs, gjuha shqipe pērdorē 1) pjesēzen ‘do’ + nē trajtē tē lidhores, ose 2) nē trajtē tē ‘pasē’ + paskajoren

1. Do tē lá-j.

2. Kam me lá.

Aspekti

Ndryshe prej kohës që tregon *të ardhemën, të tashmen, dhe të kaluomen*, aspekti nuk është deiktik, domethanë ai nuk lidhet me kohën e ligjimit; ai tregon fazat e zhvillimit të ngjarjeve.

Koha dallon në mes të së ardhemes, së tashmes, dhe së kaluomes. Aspekti dallon në mes të *kryemjes e pakryemjes* dhe në mes të *përsëritjes e vazhdimsisë*.

- **koha:** e tashmja, e ardhëmja, a kaluomja
- **aspekti:** veprimi është *i kryem ose i pakryem; i përsëritshëm* (habitual) ose aktual (i herjes). Forma e fundit del në format e vazhdimsisë, si në *po lexoj*.

1. Përballja me e kthjellët aspektore del në mes të *së pakryemes* dhe të *së kryemes* së thjeshtë. E para nuk thotë gjë për kryemjen e veprimit (punoja), ndërsa e dyta e trajton veprimin si një segment të pandashëm dhe tregon se ka mbarua, por nuk thotë gjë rreth zhvillimit të tij (punova).

E pakryemja dhe e kryemja **nuk** përfshihen në fjalinë: *Ndërsa Luka ndiqte studimet, Lula nisi me punua*, sepse trajta 'ndiqte' është shkurtim bisedor i trajtës së vazhdueshme 'po ndiqte'. Në këtë fjalë, vazhdimsia kuptohet prej fjalës 'ndërsa'.

2. Përballja tjetër del në mes të *habitualitetit* (përsëritjes) dhe *aktualitetit* (herjes). E para përfshin të tashmen dhe të pakryemen, të cilat tregojnë se një veprim ndodhë habitualisht, por që aktualiteti i tij nuk mund të dëshmohet. E dyta përfshin format e vazhdimsisë, të cilat tregojnë për një ngjarje që mund të dëshmohet në çdo grimkohë (po punoj).

Mënyrat

Zakonisht, gjuhtarët i ndajnë menyrat e foljes në *dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore, dhe urdhënore*. Habitörja është mënyrë e veçantë e gjuhës shqipe.

Dëftore:	<i>Un bā-j</i>
Habitore:	<i>Un bā-kam</i>
Lidhore:	<i>Un [duhet, mund] të bā-j</i> <i>Un kam me bā</i>
Kushtore:	<i>Un do të bā-ja</i>
Dëshirore:	<i>Un bāfsh-a; Ti bā-fsh</i>
Urdhënore:	<i>Ti, bā-n! Ju ba-ni!</i>

Ka herë kur një menyrë folieje shprehë më shumë se një menyrë, p.sh., menyra urdhënore mund të shprehë një deklaratë në mënyrën dëftore, si në, *puno e puno gjith jeten...* Trajta 'puno' është në mënyrën urdhënore, por në vend të urdhënit ajo nenkupton një të vërtetë, çka është detyra e dëftores.